

## Miratohet Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025



Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare të Diasporës Shqiptare dhe Planin e Veprimit 2021 – 2025. Dokumenti i miratuar nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe për të forcuar marrëdhëniet e Shqipërisë me Diasporën shqiptare. Kjo është Strategjia e dytë që qeveria shqiptare ka miratuar. Dy vite më parë, ajo miratoi Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2018 – 2024 i cili ishte i pari dokument në llojin e vet. Zhvillimet dinamike sollën një aplikim më të shpejtë çka solli në nevojën për rishikimin dhe përditësimin e këtij dokumenti të rëndësishme për marrëdhënien e shtetit shqiptar me Diasporën. Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025 është vazhdimi i aplikimit të strategjisë së mëparshme, mbi bazën e së cilës u miratua një legjislacion i ri dhe institucione të reja të specializuara shtetërore. Vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021. Deri në këtë datë do të zbatohet vendimi Nr.259, datë 9.5.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

## Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#):

## Presidenti dekreton ligjin për Diasporën



Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta ka dekretuar Ligjin për Diasporën, i cili kaloi në Parlament pak ditë më parë. Ndryshimet në Ligjin për Diasporën u propozuan pas krijimit të dy strukturave të reja për Diasporën, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën. Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko ndryshimet në ligjin për Diasporën përfshijnë edhe dhënien e çmimeve kombëtare dhe medaljeve për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe Diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj.

## “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

## QBD, takim me mësuesen e gjuhës shqipe znj. Fidane Zhugri

Qendra e Botimeve për Diasporën priti mësuesen e gjuhës shqipe në shkollën “ Besa” të Romës, znj. Fidane Zhugri. Tema e diskutimit të këtij takimi ishin problematikat e mësimdhënies të lindura nga situata e krijuar prej pandemisë dhe tekstet mësimore që përdoren për momentin në këtë shkollë. Ndër të tjera u diskutua për mënyrën e organizimit të mësimi të gjuhës shqipe në shkollën “Besa” në Romë. Në vijim, duke theksuar nevojën e përhapjes së gjuhës shqipe dhe promovimin e saj, znj. Fidane Zhugri u njoh me botimet e reja të Qendrës së Botimeve për Diasporën, serinë e botimeve dygjuhëshe të përrallave klasike dhe fjalori dygjuhësh për fëmijë. Në fund të takimit, Qendra e Botimeve për Diasporën i dhuroi znj. Fidane Zhugra përrallat klasike dhe fjalorin dygjuhësh.



## QBD publikon falas online fjalorin dygjuhësh për fëmijë, shqip-kroatisht

Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion të fëmijëve në Diasporë, një tjetër fjalor dygjuhësh për fëmijë: fjalorin shqip-kroatisht, në formatin e-book. Fjalori, shumë i dobishëm për mësuesit dhe fëmijët në Diasporë dhe jo vetëm, është i shkarkueshëm falas për të gjithë. Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t'i qartësuar dhe për t'i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Ky fjalor synon t'u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe, por gjithashtu mund të jetë shumë i vlefshëm edhe në procesin e mësimdhënies.



## Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

## Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## KKD i kërkon Kancelares Angela Merkel liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës



Nga fillimi i këtij muaji Gjermania e ka marrë presidencën gjashtëmuajore të Bashkimit Evropian. Me këtë rast, Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD) ia përcjell Kancelares Angela Merkel urimet më të mira si dhe kërkon angazhimin e saj për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në vijim jua sjellim të plotë përmbajtjen e letrës së nënshkruar nga 15 anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës shqiptare:

Kliko këtu [http://www.keshillikoordinuesdiaspores.com/wp-content/uploads/2020/07/Letra-per-Kancelaren\\_13korrik20-Finale-1.pdf](http://www.keshillikoordinuesdiaspores.com/wp-content/uploads/2020/07/Letra-per-Kancelaren_13korrik20-Finale-1.pdf)

## “Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):